

RREGULLORE

“PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË DETAJUARA PËR ZBATIMIN E NENEVE 4 DHE 9 TË LIGJIT NR. 9121/2003 NË SEKTORIN E TRANSPORTIT DETAR, PËRFSHIRË KABOTAZHIN DHE SHËRBIMET NDËRKOMBËTARE TË LUNDRIMIT TË LIRË (TRAMP SERVICES)”¹

Neni 1

Dispozitat që lidhen me marrëveshjet, vendimet dhe praktikat e bashkërenduara në sektorin e transportit detar zbatohen për të gjitha format e shërbimeve detare, përfshirë kabotazhin dhe shërbimet ndërkombëtare të anijeve të lundrimit të lirë, në përputhje me nenet 4 dhe 9 të Ligjit nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, të ndryshuar.

Neni 2

Autoriteti i Konkurrencës ushtron kompetencat e tij për hetimin e shkeljeve të konkurrencës dhe vendosjen e masave përkatëse administrative në përputhje me Ligjin nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, të ndryshuar.

Neni 3

Kjo rregullore hyn në fuqi me botimin e saj në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

¹ Ky akt është përafuar me Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 1419/2006, datë 25 shtator 2006, që shfuqizon Rregulloren (EEC) nr. 4056/86, e cila përcakton rregullat e hollësishme për zbatimin e neneve 85 dhe 86 të Traktatit në transportin detar, dhe ndryshon Rregulloren (KE) nr. 1/2003 lidhur me zgjerimin e fushës së zbatimit të saj për të përfshirë kabotazhin dhe shërbimet ndërkombëtare të lundrimit të lirë (tramp services).